

Driton Bajraktari – Nominuar për Bordin e Organizatës CiviKos-it

Driton Bajraktari është aktivist i SHC dhe me mbi 18 vite përvojë në menaxhimin strategjik dhe operacional të organizatave joqeveritare, si dhe në zhvillimin e ndërmarrjeve sociale në Kosovë.

Aktualisht, ai është Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit Kosovar për Ndërmarrjet Sociale, ku udhëheq me sukses iniciativat për promovimin e ndërmarrjeve sociale si mjete kyçe për zhvillim ekonomik dhe përfshirje sociale. Përvoja e tij dhe rezultatet konkrete në fushën e zhvillimit të sektorit social dhe ekonomik e bëjnë atë një kandidat të denjë për Bordin e CiviKos.

Gjatë karrierës së tij, Dritoni ka udhëhequr projekte të qëndrueshme të financuara nga Bashkimi Evropian, duke përfshirë krijimin e ndërmarrjes sociale #amë në kuadër të organizatës Down Syndrome Kosova, ku si themelues ai ka shërbyer si Drejtor Ekzekutiv dhe më pas si udhëheqës i Departamentit për Zhvillim dhe Mbledhje Fondesh. Nën udhëheqjen e tij, organizata ka arritur të rrisë ndikimin e saj në fuqizimin e personave me sindromën Down, duke sjellë ndryshime të prekshme në jetën e komunitetit. Përkushtimi i tij ndaj çështjeve sociale është njohur edhe ndërkombëtarisht, ku më 2011 ai u nderua me çmimin “Aktivitete Profesionale të Shquara” nga Down Syndrome International dhe World Down Syndrome Day.

Dritoni është diplomuar në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, në Menaxhment dhe Informatikë, shkollë të gazetarisë dhe program master në Universitetin e Utrechtit, Fakulteti i Gjeoshkencave- Zhvillim i Qëndrueshëm dhe Zhvillim Ndërkombëtar. Ai zotëron aftësi të shkëlqyera analitike dhe ndërkulturore, flet rrjedhshëm pos shqipes, edhe gjuhët serbo-kroate, angleze dhe gjermane. Kjo aftësi i mundëson atij të ndërtojë ura komunikimi efektive midis aktorëve të ndryshëm institucionalë dhe shoqërisë civile.

Në kuadër të aplikimit për anëtarë CiviKos, Dritoni synon të kontribuojë në forcimin e rolit strategjik të platformës si një mekanizëm kyç për dialogun ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve publike. Ai me përkushtim do të angazhohet për:

- ❖ Avancimin e politikave publike që promovojnë transparencën dhe bashkëpunimin efektiv midis sektorëve.
- ❖ Zhvillimin e kapaciteteve organizative brenda platformës CiviKos për t'i mundësuar shoqërisë civile një zë më të fuqishëm në proceset vendimmarrëse.
- ❖ Nxitjen e inovacionit social, duke sjellë praktikën më të mira për zhvillimin e ndërmarrjeve sociale dhe organizatat joqeveritare për zgjidhjen e sfidave komplekse socio-ekonomike, dhe që CiviKos të bëhet një platformë edhe më efektive dhe gjithëpërfshirëse, duke fuqizuar rolin e shoqërisë civile si katalizator kryesor për zhvillim demokratik dhe qeverisje transparente.

Ju faleminderit,
Fondacioni Kosovar për Ndërmarrjet Sociale-KSEF